

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË ORIKUM

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Orikum, Vlorë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 30.12.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 29, datë 26.03.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1148/6, datë 26.03.2015, i ka rekomanduar z. Kanan Braho, Kryetar i Bashkisë Orikum, zbatimin e masave të mëposhtme:

A.MASA ORGANIZATIVE.

1.Gjetje nga auditimi: Rezultoi se nuk janë zbatuar rekomandimet e lëna më parë nga KLSH, për shpërbllim dëmi për vlerën gjithsej **3,143,210 lekë**, për 2 persona:

-Z.K.B në shumën **1,571,605 lekë**, me detyrë ish-Kryetar i Bashkisë Orikum, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor.

-Znj.R.M në shumën **1,571,605 lekë**, në cilësinë e kryetarit të KVO, për shkeljet në shpalljen fitues të operatorit ekonomik konkurrues “*H....Const*”, pa plotësuar të gjitha kërkesat kualifikuese, të krahasuar me operatorin ekonomik konkurrues pjesëmarrës në tender “*Gant Konstruksion*”, mbështetur në nenin 53, pika 4 të LPP, në tenderin me objekt: “*Ndërtim Rruga e Lagjes 1 Maj Orikum*”, të zhvilluar në vitin 2011, veprime në kundërshtim me urdhrin e Kryeministrit nr. 70, datë 18.04.2006, “*Për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Shtetit dhe Auditit Brendshëm*”.

1.1.Rekomandimi: Bashkia Orikum të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore, për zbatimin e rekomandimeve të lëna më parë nga KLSH, për kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës **3,143,210 lekë** nga K.B 1,571,605 lekë dhe R.M 1,571,605 lekë, për shkeljet e konstatuara në tendera me efekte financiare me dëm ekonomik.

Menjëherë

2. Gjetje: Në planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve për paga dhe shpenzime operative, u konstatua se për vitin 2013 dhe 2014, ato janë në raport të zhdrejtë midis tyre, pasi shpenzimet operative janë më të larta se shpenzimet për paga, çka duhej të ndodhte e kundërta .

2.1.Rekomandim: Bashkia Orikum për vitin 2015, të ruaj dhe të zbatojë raportin e drejtë midis shpenzimeve për paga dhe shpenzimeve operative, në mënyrë që këta të fundit të realizohen në një nivel më të ulët krahasuar me pagat, për efekt të efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomicitetit të shpenzimeve operative, në mënyrë që shpenzimet për funksionimin e aktivitetit kryesor nga burimet njerëzore të mbulohen me më pak shpenzime operative ndihmëse.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2013 dhe 2014 nga mbikëqyrësi i shërbimit të pastrimit, nuk janë mbajtur procesverbale dhe situacione ditore, për efekt të evidentimit të saktësisë së kryerjes së volumeve dhe cilësisë zërave të punimeve të pastrimit si dhe nuk janë zbritur disa zëra pune për ditët me shi ose për rastet e ndryshimit të sipërfaqes për pastrim, në kundërshtim me kërkesat e nenit 26 të kontratës sipërmarrëse datë 16.10.2013, me nenin 43, 64, 65 të rregullores së brendshme të bashkisë pika 7 dhe me nenin 19 “*Mbikëqyrja gjatë kryerjes së shërbimit*” të kontratës sipërmarrjes.

3.1.Rekomandim: Bashkia Orikum, të kërkojë nga mbikëqyrësi i shërbimit të pastrimit dokumentimin e periudhave periodike, si procesverbal, situacion ditor, për efekt të evidentimit të saktësisë së kryerjes së volumeve dhe cilësisë zërave të punimeve të pastrimit si dhe evidentojë ndërprerjen e punës, për efekt të kursimit të disa zërave të pastrimit, të cilët nuk kryhen në ditët me reshje.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Normativat mujore të harxhimit karburantit për disa automjete të bashkisë paraqiten në nivele të larta si dhe normativat për 100 km të përshkruara ose për orë pune për disa makina dhe makineri paraqiten te larta, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” dhe udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

4.1. Rekomandimi: Bashkia Orikum të marrë masa, duke ngritur grupe pune me specialistë të fushës, e të rishikojë dhe të reduktojë normativat mujore të harxhimit karburantit dhe normativat për 100 km të përshkruara për disa automjete të bashkisë, për efekt të efijencës dhe kursimit të shpenzimeve të karburantit.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Bashkia Orikum nuk ka zbatuar procedurat ligjore për përzgjedhjen e punonjësve të policisë, pasi policët e bashkisë, nuk kanë mbaruar akademinë e rendit, nuk kanë kaluar në komisione të posaçme me përfaqësues nga Policia dhe Prefektura, sipas kritereve të Rregullores Brendshme "TIP" të Policisë të Bashkisë të miratuar me Urdhrin e Përbashkët të Ministrisë të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministrisë të Rendit, nr. 1, datë 17.04.2003, neni 11 dhe 7 “*Përzgjedhja e kandidatëve, formimi dhe kualifikimi*” pika 2 dhe 5, me nenin 4 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 “*Për Organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë*”, i ndryshuar me Ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998 .

5.1.Rekomandimi: Bashkia Orikum të marrë masa, duke zbatuar procedurat e caktuara ligjore, për emërimin e punonjësve të policisë me komisione të posaçme me përfaqësues nga Policia dhe Prefektura, si dhe të kenë mbaruar akademinë e rendit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në dy prej dosjeve teknike, kontratat e të cilave u audituan, u konstatuan mangësi në dokumentacion në kundërshtim me Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “*Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar*”, Udhëzimi Nr.3, datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar si dhe Udhëzimin nr.2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*” .

6.1 Rekomandim: Bashkia Orikum dhe Drejtoria e Zhvillimit Teritorial, të marrë masa që në dorëzimin të dosjes teknike të mbikëqyrjes të punimeve, të verifikohen nëse janë plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “*Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar*”, si dhe Udhëzimin nr.2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”. Gjithashtu, nga ana e Bashkisë Orikum të merrem masa për marrjen në dorëzim të investimeve, në përfundim të afateve përkatëse.

Në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer rezulton se në juridiksionin e Bashkisë Orikum, janë blerë apartamente dhe pronarët nuk janë të rregjistruar në gjëndjen civile të kësaj bashkie dhe shumë prej tyre nuk paguajnë detyrimin për taksë banese, mbasi nuk u dihet adresa e për rrjedhojë mungojnë të ardhura të rëndësishme për këtë bashki.

7.1. Rekomandim: Bashkia Orikum, duhet të rakordojë me ZVRPP Vlorë për emrat e qytetarëve, adresat dhe sipërfaqen e banimit të secilit prej pronarëve të banesave, duke bërë edhe verifikimin përkatës.

Menjëherë

8.Gjetja nga auditimi: Për të ardhurat nga taksa e fjetjes në hotel, rezultoi se planifikimi nuk i përgjigjet realitetit. Nga 34 hotele që ushtrojnë aktivitet, 24 prej tyre janë specifikuar persona fizikë, ndërsa 9 janë persona juridikë.

8.1.Rekomandim: Bashkia Orikum të bashkërendojë punën e saj, me Drejtorinë e Tatimeve të rrethit, për monitorimin dhe saktësimin e natyrës së subjektit, nga fizikë në juridikë.

Menjëherë

9.Gjetje nga auditimi: Bashkia Orikum megjithëse ka ndërmarrë nismën për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV), por brenda periudhës prej 2 vjet nga data e fillimit të efekteve të plota ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, të ndryshuar, konform nenit 89, pika 2, nuk ka bërë hartimin e miratimit të këtij plani, brenda afateve ligjore.

9.1.Rekomandim: Të hartohet e miratohet Plani i Përgjithshëm Vendor, jo më vonë se 2 vjet nga data e hyrjes në fuqi e Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” konform nenit 58 të këtij ligji.

Brenda vitit 2016

10.Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit e Bashkisë Orikum, gjatë periudhës 01.01.2013-31.12.2014 ka shqyrtuar 17 kërkesa për leje zhvillimore ndërtimi, të cilat pasi janë shqyrtuar në Këshillin Teknik, janë miratuar nga Kryetari i Bashkisë Orikum.

Në 8 praktikat e audituara me zgjedhje konstatohet se 6 prej tyre, në kundërshtim me VKM nr. 502, datë 13.07.2011, të ndryshuar, shtojca 2, seksioni 8, praktikat paraqesin mangësi në dokumentacion, kryesisht përsa i përket studimit sizmiologo-inxhinierik, vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe miratimit nga Agjencia Rajonale e Mbrojtjes së Mjedisit.

10.1.Rekomandim: Përpara miratimit të Certifikatës së Përdorimit, sipas kërkesave të nenit 42 të Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, ti kërkohej subjekteve zhvilluese të plotësojnë mangësitë në dokumentacionin e lejeve të zhvillimit për objektet e cituara më sipër.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Inspektoratit Mbrojtjes dhe Kontrollit Teritorit (IMKT), pranë Bashkisë Orikum për periudhën e audituar, rezulton se janë mbajtur 64 procesverbale për prishje objektesh pa leje. Në zbatim të nenit 1, të ligjit nr. 10240 datë 25.02.2010 “Për disa shtesa në ligjin nr. 9780 “Për inspektimin e ndërtimit” është kërkuar ndërhyrja e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, pasi INUV Bashkia Orikum nuk disponon mjetet e nevojshme për prishjen e këtyre objekteve.

11.1.Rekomandim: Bashkia Orikum në bashkëpunim me IMKT, të marrë masat për të siguruar mjetet e nevojshme, vlerësimin financiar, për ekzekutimin e vendimeve për prishje të objekteve pa leje në territorin e saj administrativ, duke aplikuar të gjitha masat administrative (gjobë,etj), dhe të kryej kallzim penal.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 08.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, pjesa e VI, kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 20.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, kapitulli IV (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **2,807,380 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore dhe shkallët e gjyqimit sa më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e punimeve për objektin “Rikonstruksion i kopshtit Mustafa Qemal Atatürk”, sipas kontratës të lidhur me datë 12.02.2013, ndërmjet Bashkisë Orikum dhe shoqërisë “H.....Construction”, rezultuan punime të pakryera në vlerën gjithsej **1,548,950 lekë, që përbën dëm ekonomik.**

1.1.Rekomandim: Bashkia Orikum të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës **1,548,950 lekë**, nga shoqëria “H...Construction”, vlerë e përfutur padrejtësisht nga shoqëria “H.... Construction”, për punime të pa kryera në objektin “Rikonstruksion i kopshtit Mustafa Qemal Atatürk”.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Në zbatim të punimeve për objektin “*Rrethimi i varrezave Dukat Fshat dhe Tragjas*” – Orikum, sipas kontaktës të lidhur me datë 10.11.2014, ndërmjet Bashkisë Orikum dhe shoqërisë “**I...**”, rezultuan punime të pakryera në vlerën gjithsej **1,002,870 lekë, që përbën dëm ekonomik.**

2.1.Rekomandim: Bashkia Orikum të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqësorit, arkëtimin e vlerës **1,002,870 lekë**, nga shoqëria “**INA**”, vlerë e përfituar padrejtësisht, për punime të pa kryera në objektin “*Rrethimi i varrezave Dukat Fshat dhe Tragjas*” – Orikum.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të punimeve për objektin “*Ndërtimi i tribunës së fushës së sportit*” Orikum, sipas kontaktës të lidhur me datë 9.10.2014, ndërmjet Bashkisë Orikum dhe shoqërisë “**G....a**”, rezultuan punime të pakryera në vlerën gjithsej **113,940 lekë, që përbën dëm ekonomik.**

3.1. Rekomandim: Bashkia Orikum të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqësorit, arkëtimin e vlerës **113,940 lekë**, nga shoqëria “**G....a**”, vlerë e përfituar padrejtësisht për punime të pa kryera në objektin “*Ndërtimi i tribunës së fushës së sportit*” Orikum.

Menjëherë

4.Gjetje nga auditimi: Në zbatim të punimeve për objektin “*Rrethimi i varrezave Dukat i Ri*” Orikum, sipas kontaktës të lidhur me datë 20.06.2013, ndërmjet Bashkisë Orikum dhe shoqërisë “**B...**”, rezultuan punime të pakryera në vlerën gjithsej **18,000 lekë, që përbën dëm ekonomik .**

4.1.Rekomandim: Bashkia Orikum të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqësorit, arkëtimin e vlerës **18,000 lekë**, nga shoqëria “**B..**”, vlerë e përfituar padrejtësisht për punime të pa kryera në objektin “*Rrethimi i varrezave Dukat i Ri*” Orikum.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të kontratës për tenderin e zhvilluar në vitin 2013 me objekt “Blerje gazoili”, rezultoi se në llogaritjen e çmimit për njësi të bërë nga operatori ekonomik “**Aljusa**” shpk., nuk është respektuar detyrimi kontraktor për “marzhin e fitimit”, për të cilin është ofertuar në vlerën 16.66 lekë/liter pa tvsh, duke rritur artificialisht çmimin e 1 litri gazoil në vlerën 3.34 lekë dhe për rrjedhojë operatori ekonomik “**A...a**” ka përfituar padrejtësisht vlerën **prej 60,120 lekë (15,000 litra x3.34 x20%), që përbën dëm ekonomik .**

5.1.Rekomandim: Bashkia Orikum të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqësorit, arkëtimin e vlerës **60,120 lekë**, nga shoqëria “**A..a**”, vlerë e përfituar padrejtësisht, pasi ka rritur artificialisht çmimin për 1 litër gazoil, duke mos respektuar detyrimin kontraktor.

Menjëherë

6.Gjetje nga auditimi: Sipas urdhër shpenzimit nr. 47, datë 6.3.2013, rezulton se nga Bashkia Orikum, është shpenzuar vlera **63,500 lekë**, për një drekë me 50 persona, shpenzim i kryer në kundërshtim me pikën 1/b të VKM nr. 472, datë 02.7.2011 “*Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore*”, me UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “*Për procedurat standarde zbatimit të buxhetit*”, pika 114 e kapitullit II. 3 “*Buxhetit vendor*”, me pikën 5 të VKM nr. 432 datë 28.06.2006 “*Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore*”.

6.1.Rekomandimi: Bashkia Orikum të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqësorit, arkëtimin e vlerës **63,500 lekë**, për shpenzim të paligjshëm për 1 drekë, sipas listës të 50 personave që disponohet në Bashkinë Orikum.

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE

Mbështetur në nenin 5/b të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014 dhe nenin 15 "Sanksionet", të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, i ka kërkuar ***Kryetarit të Bashkisë Orikum ti propozojë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore të Qarkut Vlorë***, që ka në juridiksion territorin ku ndodhen objektet e trajtuara sipas kontratave (duke i bashkëlidhur fotokopjen e procesverbalit përkatës që trajton çështjen), që të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur sanksionet si më poshtë:

A. Dënimin me gjobë:

1. Për subjektin mbikëqyrës të punimeve të ndërtimit, "E.../M" sh.p.k., :

a. Përfaqësuar nga ***G.G dhe F.G, mbikëqyrës të punimeve***, për mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit për objektin "*Rrethimi i varrezave Dukat Fshat dhe Tragjas*", për shkak se:

-Punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit e të zbatimit dhe librezat e masave për përshkrimin e punimeve sipas grafikut dhe projekt zbatimit, nuk pasqyrojnë me vërtetësi punimet e kryera për të përcaktuar saktë volumet e punimeve. Si rezultat i situacionimit, me diferenca volumesh të pa kryera në vlerën **1,002,870 lekë**, ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga operatori ekonomik "*INA*" sh.p.k.

b. Përfaqësuar nga ***F. G, kolaudator i punimeve në objektin "Rikonstrukcion i kopshtit Mustafa Qemal Ataturku"***, për shkak se:

Punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit e të zbatimit dhe librezat e masave për përshkrimin e punimeve sipas grafikut dhe projekt zbatimit, nuk pasqyrojnë me vërtetësi punimet e kryera për të përcaktuar saktë volumet e punimeve. Si rezultat i situacionimit, me diferenca volumesh të pa kryera në vlerën **1,548,950 lekë**, ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga operatori ekonomik "*H...*" sh.p.k.

Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 "Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit", të ndryshuar dhe me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" dhe me udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", Kreu II, Pika 3.

2. Për znj. E.V,

a. Kolaudator i punimeve për objektin "*Rrethimi i varrezave Dukat Fshat dhe Tragjas*", për shkak se:

-Punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit e të zbatimit dhe librezat e masave për përshkrimin e punimeve sipas grafikut dhe projekt zbatimit, nuk pasqyrojnë me vërtetësi punimet e kryera për të përcaktuar saktë volumet e punimeve. Si rezultat i situacionimit, me diferenca volumesh të pa kryera në vlerën **1,002,870 lekë**, ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga operatori ekonomik "*I..*" sh.p.k.

b. Mbikëqyrës i punimeve, në objektin "Ndërtimi i tribunës së fushës së sportit", për shkak se:

-Punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit e të zbatimit dhe librezat e masave për përshkrimin e punimeve sipas grafikut dhe projekt zbatimit, nuk pasqyrojnë me vërtetësi punimet e kryera për të përcaktuar saktë volumet e punimeve. Si rezultat i

situacionimit , me diferenca volumesh të pa kryera në vlerën **113,940 lekë**, ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga operatori ekonomik “ G.... ” sh.p.k.

Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

- Për mangësi në dokumentacion në kundërshtim me udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011, “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4, dhe me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001”Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar dhe me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” dhe me udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3 (trajtuar në procesverbalin nr. 3, datë 15.01.2015, procesverbalin nr.4 datë 16.01.2015 dhe në faqet 57-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

Mbështetur në nenet 10,15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, bazuar në Vendimin e Këshillit Ministrave nr. 42, datë 16.1.2008 “ Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së Liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ndryshuar me VKM nr. 92, date 19.02.2014, Kreu VII, “Sanksione”, pika 1,shkronja (a), Pika I- Konstatohen ose provohen deklarime, të rreme, i i ka rekomanduar Komisionit të dhënies së Liçencave, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, që për shkelje të ligjshmërisë në ndërtim të vendosë sanksionet si më poshtë:

-Heqjen e Liçencës, për një afat prej 1-2 vjet” për:

Për subjektin mbikëqyrës të punimeve të ndërtimit, “E./M” sh.p.k. :

a. Për mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit për objektin “Rrethimi i varrezave Dukat Fshat dhe Tragjas”, për shkak se:

-Punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit e të zbatimit dhe librezat e masave për përshkrimin e punimeve sipas grafikut dhe projekt zbatimit, nuk pasqyrojnë me vërtetësi punimet e kryera për të përcaktuar saktë volumet e punimeve. Si rezultat i situacionimit , me diferenca volumesh të pa kryera në vlerën

1,002,870 lekë, ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga operatori ekonomik “ INA ” sh.p.k.

b. Për kolaudimin e punimeve në objektin “Rikonstruktion i kopshtit Mustafa Qemal Atatürk”, për shkak se:

Punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit e të zbatimit dhe librezat e masave për përshkrimin e punimeve sipas grafikut dhe projekt zbatimit, nuk pasqyrojnë me vërtetësi punimet e kryera për të përcaktuar saktë volumet e punimeve. Si rezultat i situacionimit , me diferenca volumesh të pa kryera në vlerën **1,548,950 lekë**, ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga operatori ekonomik “ H...Construcion ” sh.p.k.

Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001”Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar dhe me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” dhe me udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3 (trajtuar në procesverbalin nr. 1, datë 07.01.2015).

Nga Bashkia Orikum, me shkresë nr. 599, prot, datë 08.04.2015, protokolluar në KLSH me nr.1148/6 datë 08.04.2015, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Besim Bileri, Milo Bano, Genc Koka dhe Jonild Hoxhaj, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT